

## **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil merr pjesë në Konferencën e IV-të Shkencore Studentore në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë**

Në ambientet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, u zhvillua Konferenca e IV-të Shkencore Studentore me temë: *“Nga Auditori në Tregun Dixhital: Strategjitë e Studentëve për Zhvillimin e Aftësive të Reja në Epokën e Inteligjencës Artificiale”*.



Në këtë aktivitet me rëndësi akademike dhe institucionale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), ishte e ftuar në panelin e hapjes së konferencës, përkrah autoriteteve drejtuese të universitetit dhe përfaqësuesve të botës akademike.



Prania e Komisioneres në këtë konferencë dëshmoi rëndësinë që institucionet publike i kushtojnë bashkëpunimit me universitetet, si dhe mbështetjes së brezit të ri në përgatitjen profesionale për sfidat e administratës moderne dhe tregut të punës.

Në fjalën e saj, Komisionerja theksoi se:

“Bashkëpunimi mes universiteteve, botës akademike dhe institucioneve publike është kyç për të krijuar ura të qëndrueshme mes formimit universitar dhe tregut të punës.”

Ajo nënvizoi se investimi në edukim cilësor, zhvillimi i aftësive profesionale dhe orientimi i studentëve drejt standardeve të meritokracisë dhe shërbimit civil përbëjnë elementë thelbësorë për ndërtimin e një administrate publike efikase, të përgjegjshme dhe në shërbim të qytetarëve.



Rektori i Universitetit Mesdhetar, Prof.Dr. Adrian Civici theksoi se Universiteti duhet të jetë hapësirë, ku studentët, jo vetëm përvetësojnë dije, por zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike për t'u përballur me transformimet që sjell ekonomia dhe tregu digjital.



Konferenca mbledhi studentë dhe pedagogë nga programe të ndryshme studimi, si dhe pjesëmarrës nga universitete të tjera të vendit, duke krijuar një hapësirë të vlefshme debati mbi ndikimin e inteligjencës artificiale, transformimin dixhital dhe nevojën për aftësi të reja në tregun e punës.

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur ciklet e praktikës profesionale dhe internshipeve, për afrimin e studentëve me administratën publike dhe promovimin e standardeve të profesionalizmit, transparencës dhe shanseve të barabarta në shërbimin civil.